

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Këshilli i Sigurisë përforcon alibinë e Ramës për Vlora Hysenin - Reporter.al
ADRESA	https://www.reporter.al/2026/09/28/keshilli-i-sigurise-perforcon-alibine-e-rames-per-vlo-ra-hysenin/
BURIMI	reporter.al
GJENDJA	online

KOHÀ


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 15:31:51 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 1800 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 15:09:27 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6e12dae662af1478bdaf330b3b8fa6ca1fda9946535159187dc9c17cdc99f06c
TEKSTI	fec98df94bc3e701dfc24cc3045fdc5459dc4cec690c77bbe43b31357c64586
PAMJA	7ad7fe57a999e431006ad542bd7517fb3145214c15c5888ac6b5fed03cc8a09c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a6e946d26818363270ac7e84d5f4bd513a2a3dd0c5a07723d373d29674b4e1a9
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	2a9c3c61cd0a94fc8d628189ad3d77be9fe8dbec0733dde85be2277fcec101e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/a6e946d26818363270ac7e84d5f4bd513a2a3dd0c5a07723d373d29674b4e1a9>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Këshilli i Sigurisë përforcon alibinë e Ramës për Vlorë Hysenin

nga Aleksandra Bogdani — 3 seconds më parë në Lajme Koha e leximit: 2 min lexim

AA 0



Nga mbledhja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare. Foto kortezi: Presidenca.

Presidenti i Republikës, Bajram Begaj, mbledhi të hënën me dyer të mbyllura Këshillin e Sigurisë Kombëtare pas vendosjes në "arrest shtëpie" nga Gjykata e Posaçme të ish-drejtoreshës së Shërbimit Informativ të Shtetit, Vlorë Hyseni.

Në një deklaratë të shpërndarë për mediat pas përfundimit të takimit, Presidenca kërkoi që institucionet e sigurisë të mos konkurrojnë me njëri-tjetrin, duke i bërë jehonë qëndrimin të kryeministrit Edi Rama se përgjegjësia në rastin e goditjes nga SPAK është tërësisht individuale.

"Hetimet e drejtësisë të zhvillohen tërësisht të pavarura dhe të respektohen nga të gjithë. Çështjet individuale të mos kthehen në krizë besimi ndaj shtetit dhe ndaj institucioneve të sigurisë", thuhet në deklaratën e lëshuar pas takimit. Në deklaratë bëhet e qartë që Këshilli është një organ thjesht këshillimor.

Përpos Presidentit, një përfaqësuesi të Prokurorit të Përgjithshëm, drejtuesit të SPAK, Klodian Braho dhe kreut të Shtabit të Përgjithshëm, pjesa tjetër e Këshillit të Sigurisë përbëhet nga kryeministri dhe ministra të kabinetit, përfshi edhe kreun e Kuvendit, Niko Peleshi.

Në takimin me dyer të mbyllura nuk pati përfaqësues të opozitës.

Partia Demokratike reagoi ashpër përmes një deklaratë, ku e cilësoi Këshillin si një "maskaradë të pëshitur, e orkestruar nga po ata krerë institucionesh që e zhytën vendin në këtë humnerë pasigurie, kriminaliteti dhe degradimi". PD ngriti pikëpyetje mbi legjitimitetin e anëtarëve të Këshillit, duke theksuar se shumica e tyre "janë të kapur mat në përgjime, në pazare të pista dhe në bashkëqeverisje të hapur me krimin".

Ndërsa deputeti i Partisë Mundësia, Erald Kapri e ironizoi takimin dhe e akuzoi Këshillin se po përdorej për të sulmuar Prokurorinë e Posaçme. "Janë mbledhur Rama me ministrat e vet edhe me noterin, Presidentin e Republikës për të gjetur një klekë të re për të goditur SPAK-un", tha Kapri.

Thirrja e Këshillit të Sigurisë vjen pak ditë pasi GJKKO la në fuqi masën e sigurisë "arrest shtëpie" për ish-shefen e SHISH, e cila po hetohet në kuadër të dosjes së njohur si "afëra e AKSHI-t". Vlorë Hyseni akuzohet nga Prokuroria e Posaçme për përkrahje të autorit të krimit dhe nxjerrje të të dhënave sekrete, në atë që përbën një ndër goditjet më të rënda në sektorin e inteligjencës shtetërore. Qëndrimi i institucionit të Presidencës duket se sinkronizohet me linjën e mbrojtjes politike të zgjedhur nga Kryeministri Edi Rama, i cili e shkarkoi Hysenin duke u rikthyer tek teza e "përgjegjësisë personale" për të shmangur faturën institucionale.

Këshilli i Sigurisë përforcon alibinë e Ramës për Vlorë Hysenin

17:09 | 28/09/2026

Iluzioni i bumit të produktivitetit nga IA-ja

14:20 | 28/09/2026

Industria nxjerrëse në Shqipëri shënoi turrje gjatë vitit 2025

12:57 | 28/09/2026

Një klikim, mijëra lekë: Si po bien shqiptarët në grepin e 'mashtimit kompjuterik'

07:59 | 28/09/2026

Evropa duhet të zgjedhë mes fuqisë dhe varësisë

19:00 | 27/09/2026

Arbëreshët e Sicilisë: një identitet shekullor që po zbehet

07:18 | 27/09/2026

Reporter.al

[Opinion](#)
[Reportazhe](#)
[Analiza](#)
[Investigime](#)
[Lajme](#)
[Blog](#)
[Rajoni](#)

[Rreth nesh](#)
[Stafi](#)
[Kontakttoni](#)
[Ankesa dhe Korrigjime](#)
[Politika e privatësisë dhe rregulla të tjera](#)
[Letra për redaktorin](#)

Follow Us



Të gjitha të drejtat janë të rezervuara
© 2014 - 2026 Reporter.al - BIRN
Dev by [Slida.PRO](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.